

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN PEZË, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Pezë, Tiranë**, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.09.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 20, datë 21.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 936/6, datë 21.03.2014, i ka rekomanduar z. Enver Dorzi Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Nga ana e Komunës Pezë për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, të KLSH dërguar me shkresën, nr. 332/5, datë 26.01.2012, të ndiqen të gjitha procedurat administrativo-ligjore, për arkëtimin e shumës së mbetur **prej 218,990 lekë, si më poshtë:**

- Vlera **168,250 lekë**, nga subjekti “Sh...M”, përfituar pa drejtësisht, për punime të pa kryera, në objektin “Kanalizim i Ujërave të Zeza Kodrasenaj Pezë-Helmes”.

- Vlera **50,740 lekë**, nga subjekti “A...T”, përfituar pa drejtësisht, për punime të pa kryera, në objektin “Hapje pusi për ujë të pijshëm Pezë e Madhe”.

Brenda muajit Maj 2014

a. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat tatimore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për të ardhurat e munguara, në vlerën **6,768,301 lekë, si më poshtë:**

2. Nga ana e Zyrës së taksave të Komunës Pezë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 për të 2 llojet e taksave të popullatës në vlerën **6,151,021 lekë**, përkatësisht; për taksën e tokës nga 1657 familje në vlerën 4,576,021 lekë dhe taksën e banesave nga 1733 familje në vlerën 1,575,000 lekë. (Lista me Personat debitorë për taksën e tokës dhe banesave paraqiten në Aneksin nr. 6 dhe nr. 7)

Deri me datën 30 shtator 2014

3. Nga ana e Zyrës së taksave, për 7 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për vlerën **240,350 lekë**, të pasqyruara në Aneksin nr.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi të nxirren njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimet

tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar **të veprohet si më poshtë;**

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b. Ndaj personave debitorë, veçanërisht për taksën e tokës dhe ndërtimit, ti kërkohet vendosja e barrës sigurorese (Drejtorinë Rajonale të Transportit Tiranë për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, kjo bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”.

c. Në rast se subjektet edhe pas njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa ndëshkuese administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008), të procedohet me kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

Deri me datën 30 qershor 2014

4. Komuna Pezë, të marrë masat për rregjistrimin në QKR dhe arkëtimin e detyrimit në shumën **261,000 lekë**, nga 6 subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa regjistruara në QKR (pa licencuara), në të kundërt, tu vendoset gjobë në masën 25,000 lekë, sipas nenit 112, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe tu mbyllet aktiviteti. Në rast mos arkëtimi të detyrimit të kryhet konfiskimi i materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe nenin 41 të ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (*Lista me personat debitorë të cilët nuk janë regjistruar në QKR, deri më datën 31.12.2013, paraqitet në Aneksin Nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda muajit Maj 2014

5. Nga ana e Punonjësit të Policisë së Komunës të merren masa për arkëtimin e 26 gjobave të pa paguara deri më datën 31.12.2013, për vlerën **115,000 lekë**, sipas listës në Aneksin nr.5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të dispozitave ligjore të mëposhtme;

- ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 ku përcaktohet se: Gjobat paguhen në favor të komunës brenda 15 ditëve nga data kur organi përkatës ka nxjerrë vlerësimin.

- ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” përkatësisht nenet, 9, 22 dhe 30.

Brenda muajit Maj 2014

6. Nga Komuna Pezë, të merren masa dhe të përsëriten procedurat e përzgjedhjes (emërimit) të punonjësit të Policisë së Komunës, duke zbatuar kriteret e urdhrat të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”, pikat 4 dhe 5 ku përcaktohet se: asnjë punonjës i policisë bashkiake e të komunës, nuk vendoset në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit sipas programit të miratuar për këtë qëllim. (Trajtuar në faqen 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Brenda muajit Maj 2014

7. Nga Komuna Pezë, të kryhet një studim për riorganizimin dhe rentabilitetin ekonomik të aktivitetit të ujësjellësit, duke e shoqëruar edhe me masat e mëposhtme;

- lidhjen e kontratave me konsumatorët familjarë dhe jo familjar me detyrimet përkatëse duke vendosur edhe penalitete (kamat vonesa).
- prodhimin e faturave të ujit të pijshëm me numër serie duke u miratuar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të regjistrohen në kontabilitet, si për sasinë e ujit të shitur dhe vlerën e paguar, duke nxjerrë debitorë personat të cilët nuk paguajnë dhe llogaritur edhe kamat vonesat përkatëse apo deri në ndërprerjen e ujit të pijshëm.
- faturat e ujit të pijshëm të plotësohen nga një person tjetër i cili nuk duhet të ketë lidhje edhe me grumbullimin e lekëve.
- të caktohet një nga hidraulikët edhe me detyrën e inspektorit të ujit të pijshëm.
- blloqet e faturimit të ujit të pijshëm të administrohen si letra me vlerë, siç përcaktohet në Kreun IV, pika 80, të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- për administrimin e ujësjellësit të Komunës Pezë, të kihet parasysh edhe kërkesat e tjera të përcaktuara në VKM nr. 236, datë 10.05.1993 ”Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.1997; udhëzimi nr. 3, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për administrimin e ujit të pijshëm” dhe legjislacioni në fuqi.

Brenda muajit Maj 2014

8. Nga Komuna Pezë, të merren masa që personat fizikë të cilët therin bagëtitë dhe pajisen me raport veteriner për konsumimin e mishit, të detyrohen të paguajnë taksën e therjes, sipas tarifave të cilat duhet të përcaktohen nga Këshilli i Komunës.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Komunës.

9. Nga Zyra e Taksave, ti dërgohen Zyrës së financës lista e debitorëve për detyrimet fiskale në fund të vitit 2013, me qëllim regjistrimin si debitorë, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të tyre.

Menjëherë

10. Nga ana e Zyrës së Taksave dhe Policisë së Komunës të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t’i propozohet këshillit të Komunës, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”.

Menjëherë

11. Për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve nga ana e Zyrës së Taksave Komuna Pezë, ndaj subjekteve të cilët nuk zbatojnë afatet e përcaktuara sipas tremujorëve, të aplikohet dënim me gjobë, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat Tatimore” i ndryshuar.

Menjëherë dhe vazhdimisht

12. Nga Komuna Pezë për blerjen e mjetit TIP, “Fadroma” sipas kontratës tenderit datë 28.05.2013, në vlerën prej 2,730,000 lekë, të hartohet kontratë shitje para noterit publik, në zbatim të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i R.SH.” me ndryshime, neni 710 “Detyrimet e shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme”, pika 2. Me qëllim që mjete të kalojnë në pronësi të Komunës Pezë si dhe të pajiset me leje qarkullimi, në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998”Kodi Rrugor i R.Sh”, neni 92, pika 1, Dokumentimi i qarkullimit dhe regjistrimit”.

Menjëherë

13. Nga Zyra e Financës të merren masa për sistemimin e gjendjes së llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në hartimin e bilancit të vitit 2013, e cila gabimisht ka kaluar në llogarinë 214

“Instalime, pajisje, vegla”, në përputhje me kërkesat e nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për pasqyrat financiare”, VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Menjëherë

14. Nga Zyra e Financës të merren masa që listëpagesat të hartohen me të gjithë elementët e pagës në përputhje me disiplinën financiare, pasi ato përfaqësoheshin vetëm nga lista emërore e punonjësve me shumat neto përkatëse. Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, manuali në zbatim të tij pika 4.3 “Sistemi i kontabilitetit financiar”, pikat 35/b, 36 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.211. “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Menjëherë

15. Nga Komuna Pezë, të merren masa që të plotësohen dosjet individuale të punonjësve me dokumentacionin e domosdoshëm të munguar sipas rastit, si dhe në të gjitha rastet të bëhet noterizimi i tyre, në përputhje me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit” të përcaktuar në Aneksin I dhe II.

Menjëherë

16. Nga Kryetari i Komunës Pezë, të dërgohet në Këshillin e Komunës, materiali dhe projektvendimi “Për një studim në lidhje me ngarkesën me punë të gjithë zyrave të Komunës”, veçanërisht për Zyrën e Taksave, duke synuar shkurtimin e strukturave të tepërta (reduktimin e punonjësve me arsimin e mesëm) dhe uljen e numrit të punonjësve në organikë, me qëllim pakësimin e shpenzimeve administrative.

Menjëherë

17. Nga Komuna Pezë (Sektori i Kulturës), të merren masa që për organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive, të miratohen dhe të financohen në bazë të projektit të plotë të shoqëruar me preventiva paraprak. Të plotësohet dokumentacioni i plotë dhe të ndiqen deri në financimin e projektit. Në zbatim të rregullores së Komunës Pezë, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Komunës nr. 20, datë 26.03.2012 në rubrikën “Detyrat e Zyrës së Kulturës” pika 7, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 pika (dh), (e), me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Vazhdimisht.

18. Nga Komuna Pezë, të merren masa për sigurimin e fondeve dhe likuidimin ndaj operatorit ekonomik “Derbi, detyrim ky i krijuar në mungesë të fondeve, si pasojë e lidhjes së kontratës datë 05.10.2012, me vlerën 4,799,280 lekë, për blerjen e projektit “Hartimi i instrumentit vendor të planifikimit të territorit”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu V pik 1/ (ç).

Brenda datës 30.06.2014

19. Nga Komuna Pezë, për familjet “ekstremisht” në nevojë, të miratohen në Këshillin e Komunës kriteret më specifike si dhe të përcaktohen në mënyrë të detajuar dokumentacioni argumentues i përfitimit të ndihmës ekonomike të financuar nga të ardhurat e Komunës, me qëllim shmangien e abuzimeve në shpërndarjen e këtij fondi. Bazuar në nenin 29 pika 9, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Menjëherë

20. Nga Komuna Pezë, të merren masa që në mbyllje të programit buxhetor të bëhet analiza vjetore të treguesve të realizimit të buxhetit dhe të miratohet në Këshillin e Komunës në përputhje me nenin

19 pika 8 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar.

Menjëherë

21. Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës Pezë, të ndiqet procedura për 367 objektet të cilat janë në proces legalizimi nga viti 2006, respektivisht; 207 ndërtime në fshatin “Pezë Helmës”, 63 në fshatin “Pezë e Vogël”, 41 në fshatin “Pezë e Madhe”, 30 në fshatin “Maknor” dhe 19 ndërtime në fshatin “Varosh”.

-Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas ligjit, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, ti kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme.

-Në çdo rast kundërvajtësi të paraqes, së bashku me kërkesën për zhvillim, dokumentin që vërteton pagimin e gjobës së vënë, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtjen administrative, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

-Kryeinspektori INU Komunës Pezë në të gjitha rastet kur është mbajtur proces-verbal konstatim kundërvajtje për objektet pa leje ndërtimi dhe shtesa kati pa leje ndërtimi mbi objektet ekzistuese, duhet vazhduar me tej proceduara ligjore.

Vazhdimisht

22. Nga ana e kryetarit të Komunës Pezë, të ngrihet një grup pune me persona përgjegjës dhe afate konkrete, të sistemohet dhe riklasifikohet gjithë dokumentacioni i Komunës Pezë, që nga krijimi i saj, duke vepruar në përputhje me ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për Arkivat”, Rregullorja “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, Për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Dokumentacioni i sistemuar dhe i klasifikuar sipas afateve dhe viteve, në bashkëpunim dhe rakordim edhe me Zyrën Rajonale të Arkivit Tiranë, të dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Brenda datës 30.09.2014

23. Për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, rekomandojmë;

-të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të Komunës Pezë, me qëllim që të mundësojë detyra të qarta dhe rregullta edhe për funksionimin e aktivitetit të ujësjellësit të qytetit.

-të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si; data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën **78,400 lekë, si më poshtë:**

1. Nga ana e Zyrës Taksave dhe Zyrës së Financës, të Komunës Pezë, të kryhen ndalesat në listë pagesat e punonjësve të administratës të cilët deri më datën 30.11.2013, nuk kanë paguar taksën e tokës dhe banesës për vitet 2011-2012, për vlerën prej **45,650 lekë**, respektivisht: 2 punonjësit e administratës së komunës, 4 anëtarët e Këshillit të Komunës dhe 2 Kryepleqtë e fshatit. *Lista e këtyre punonjësve pasqyrohet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Menjëherë

2. Nga Komuna Pezë, të merren masa për arkëtimin e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2011, 2012 dhe 9 mujorin 2013, për mos pagesën e faturave të ujit të pijshëm nga 11 abonentë jo familjarë për vlerën **32,750 lekë**. Në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.2007 dhe udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për administrimin e ujit të pijshëm", *Pika.*

Deri me datën 30 shtator 2014

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003, dhe Kontratat individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Pezë, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 10 punonjësit** si më poshtë:

Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, për:

1. **K.SH.** me detyrë Përgjegjëse Zyrës së Juridike dhe në cilësinë e administratores së dosjeve të personelit. *Për shkeljet e mëposhtme:*

-Nga mos kontrolli i dosjeve të personelit rezulton se, në 10 raste mungojnë, kërkesat për punësim, listat e notave, raportet mjekësore, librezat e punës etj. Po kështu dokumentacioni që përmbante dosja individuale e personelit në pjesën më të madhe dokumentet ishin të pa noterizuara. Mos plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit" Aneksin I dhe II.

-Për mos përcaktimin e kritereve për ndihmën ekonomike dhe dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me argumentimin e vendimit të marrë nga Këshilli i Komunës, për vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve "ekstremisht" në nevojë. Në kundërshtim me neni 29 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar.

2. **H.I.** me detyrë përgjegjës e Zyrës së Ndihmës Ekonomike,

-Për mos përcaktimin e kritereve për ndihmën ekonomike dhe dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me argumentimin e vendimit të marrë nga Këshilli i Komunës, për vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve "ekstremisht" në nevojë. Në kundërshtim me neni 29 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar.

3. **L.Ç.** me detyrë specialiste finance dhe hartuese e listë-pagesave.

-Për mos hartimin e listpagesave sipas standardeve të kontabilitetit, pasi ato nuk plotësoheshin, me të gjithë elementet e pagave dhe shtesave të ndryshme të përfituara llojet e ndalesave deri tek paga neto. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4, pika 26, manuali në zbatim të tij, pika 4.3 “Sistemi i kontabilitetit financiar” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 35/b, 36.

Pesë punonjësit e Zyrës së Taksave si më poshtë:

1. **A.SH.** me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Taksave,
2. **G.M.** me detyrë Inspektor i Taksave,
3. **H.XH.** me detyrë Specialiste Licencash (në detyrë nga data 01.02.2012 e në vazhdim),
4. **R.K.** me detyrë Inspektor i Taksave (në detyrë nga data 01.09.2012 e në vazhdim),
5. **A.B.** me detyrë Inspektor i Taksave (në detyrë nga data 01.03.2013 e në vazhdim)

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos arkëtimin e debitorëve të taksave të popullatës, pasi deri datën 31.12.2013 gjendja e debitorëve, për të 2 llojet e taksave të popullatës paraqitet në vlerën **6,151,951 lekë**, përkatësisht; nuk kanë paguar taksën e tokës 1657 familje në vlerën 4,576,021 lekë dhe taksën e banesave nga 1733 familje në vlerën 1,575,000 lekë.

-Edhe pse janë evidentuar 7 subjekte të cilët janë debitorë deri më datën 30.09.2012 në vlerën 240,350 lekë, nga të cilët 3 subjekte nuk kanë paguar taksat për 2 vite rradhazi, 2011- 2012 në vlerën 148,880 lekë, ndërkohë ndaj tyre nga punonjësit e taksave nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme **ligjore si më poshtë:**

- nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.”

-nuk janë marrë masa dhe nuk u janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

-nuk është kërkuar kallëzim penal, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09, 2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar ligjit dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

-ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar detyrimet në afat, nuk u janë vendosur masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit), sipas nenet 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6. S.B. me detyrë punonjësi i policisë së komunës

-Nga ana e punonjësit të Policisë së Komunës, gjatë veprimtarisë së tij nuk janë zbatuar kërkesat e urdhrat të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës” .

-Ndërmjet policisë së komunës dhe zyrës së taksave së Komunës Pezë nuk ka këmbim informacioni zyrtar nëpërmjet zyrës së protokollit, por bashkëpunim verbal dhe nga punonjësit e policisë komunës nuk njihet gjendja dhe nuk dihej numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në komunën Pezë.

-Për periudhën 2 vjeçare 2011-2012 dhe 9/mujorin 2013 nga ana e Policisë së Komunës Pezë, janë vendosur 34 gjoba në vlerën 146,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 8 gjoba në vlerën 31,000 lekë, ose në masën 22%, duke mbetur pa u arkëtuar më datën 30.12.2013 edhe 26 gjoba në vlerën prej 115,000 lekë. Ndërkohë nuk janë marrë masa për nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin arkëtimin e tyre të përcaktuara në:

-ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 14 pika 2 ku përcaktohet se: Gjambat paguhen në favor të komunës brenda 15 ditëve nga data kur organi përkatës ka nxjerrë vlerësimin.

-ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" përkatësisht nenet, 9, 22 dhe 30.

7. F.Ç. ish-punonjëse e zyrës protokoll-arshivës, për periudhën 2007-2013, aktualisht llogaritar-arkëtare.

Për mos kryerje detyre në lidhje me sistemin e dokumentacionit të zyrës së arkivit, me pasojë mos sistemimin e dokumentacionit që nga krijimi i Komunës, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", Rregullorja "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore", Për "Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (Trajtuar në faqen 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako, Mirland Cela, Irma Shkupi, dhe Hodo Hasani më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT